



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 25.4.2023

Nr: 405

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË DISA
INSTITUCIONEVE, PËR PERIUdhËN 7 PRILL – 13 PRILL 2023**

Sot, më datë 25.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Prefekti i Qarkut Fier, Bashkia Elbasan, Bashkia Sarandë, Bashkia Devoll, Bashkia Shijak.

OBJEKTI: Vlerësim i veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 7 prill deri më 13 prill 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 7 prill deri më 13 prill 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike, janë raportuar gjithsej 244 aktivitete nga 55 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se 11 aktivitete të zhvilluara nga 6 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Nga këto veprimtari të raportuara jashtë afatit ligjor, janë ndaluar 4 veprimtari publike, të planifikuara për t'u zhvilluar nga Bashkia Belsh.

Për aktivitetet e tjera të pandaluara, të raportuara në tejkalim të afatit ligjor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kryer shqyrtimin administrativ si vijon;

1. **Prefekti i Qarkut Fier** ka raportuar nëpërmjet emai - it 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet *“Ftesë për pjesëmarrje nga Mitropoliti i Apollonisë dhe Fierit, Hirësia e tij At Nikolla me rastin e pashkëve Orthodhokse”*, raportuar në datë 12.4.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 16.4.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në email dhe nga rrethanat dhe faktet, rezulton se Prefekti i Qarkut Fier nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

2. **Bashkia Elbasan** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet *“Inspektime në objektin “Argjinatura mbrojtëse e lumit Shkumbin dhe infrastruktura ndihmëse e Automotoparkut”*, raportuar në datë 13.4.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 17.4.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në ndërfaqen e raportimeve dhe nga rrethanat dhe faktet, rezulton se Bashkia Elbasan ka njoftuar nëpërmjet email – it datë 14.4.2023 dhe ka sqaruar se *“në vijim të raportimit në ndërfaqen online të Kqz, ju informojmë se gabimisht (lapsus) është raportuar agenda politike dhe jo ajo publike e kryetarit të Bashkisë Elbasan për datën 17.4.2022. Lutem nga ana juaj të merret në*

konsideratë ky email sqarues, pasi për shkak të agjendës së mbingarkuar të ditëve dhe riorganizimit të punëve, ka ndodhur edhe mismatch i agjendave (politike vs. publike).”

Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Në kuptim të tij, nuk raportohen në KQZ veprimtaritë politike/elektorale si dhe në këto veprimtari ndalohet pjesëmarrja e nëpunësit dhe funksionarit publik gjatë orarit zyrtar të punës. Në këto kushte, gjendemi para një lapsusi që ka kryer Bashkia Elbasan, e cila gabimisht ka raportuar agjendën politike të Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si kandidat për Kryetar Bashkie, marrë parasysh edhe faktin se data e zhvillimit të aktivitetit 17 Prill 2023, ishte pushim zyrtar për të gjithë administratën publike. Për sa më lart, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk jemi para kundërvajtjes administrative, për sa kohë që këto aktivitete nuk duhet të raportohen në ndërfaqen e KQZ – së.

3. **Bashkia Sarandë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Promovim i librit “Qytetit të lindjes Saranda”*, raportuar në datë 11.4.2023 për t’u zhvilluar në datë 15.4.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në ndërfaqen e raportimeve dhe nga rrethanat dhe faktet rezultoi që Bashkia Sarandë nëpërmjet email – it datë 20.4.2023 ka sqaruar se *“aktivitet “Promovim i librit “Qytetit të lindjes Saranda, është aktivitet i organizuar nga shoqata klubi i krijuesve “Jonian” dhe Bashkia Sarandë ishte e ftuar ka marrë dizeni në datë 11.4.2023 ditë në të cilën është raportuar nga ana jonë ”*. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se Bashkia Sarandë nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

4. **Bashkia Devoll** ka raportuar nëpërmjet email - it 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Dita Ndërkombëtare Rome”*, raportuar në datë 9.4.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 11.4.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në email dhe nga rrethanat dhe faktet, rezultoi që Bashkia Devoll nëpërmjet email – it datë 9.4.2023 ka sqaruar se *“Në kuadër të udhëzimeve për zhvillimin e veprimtarive në këtë periudhë parazgjedhore, po iu shkruaj për t’iu venë në dijeni në lidhje me një aktivitet të përvitshëm që Bashkia Devoll organizon në kuadër të 8 Prillit, Ditës Ndërkombëtare Rome. Për këtë vit, vetëm në momentin e fundit e përcaktuam ditën kur do të zhvillohet veprimtaria për shkak se është në bashkëpunim me UNDP dhe agjenda e tyre ndryshoi deri në sekondat e fundit. Aktiviteti do të zhvillohet më dt. 11.04.2023, ora 11, në ambientet e restorant Mylazimi ne Bilisht, E gjithë veprimtaria është e përqendruar te komuniteti rom, kultura, tradita dhe historia e tyre. Aktiviteti është në kuadër të projektit Riintegrimi i të rikthyerve Romë dhe Egjiptianë, mbështetur nga UNDP në bashkëpunim me Bashkinë Devoll dhe të pranishëm do të jenë kryetari i Bashkisë Devoll, përfaqësues nga UNDP, përfaqësues nga komuniteti Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Devoll, stafi i qendrës shumëfunksionale komunitare, nxënës shkollash të përfshirë në veprimtarinë muzikore dhe interpretuese me recitime. Bashkëngjitur do të gjeni dhe ftesën e aktivitetit.”*

Për sa më lart, rezultoi se Bashkia Devoll nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit nga UNDP. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

5. **Bashkia Shijak** ka raportuar nëpërmjet email - it 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Aktiviteti ka si qëllim paraqitjen e punës së kryer nga Këshilli Vendor Rinor Shijak dhe paraqitjen e planit të aktiviteteve rinore për vitin 2023”*, raportuar në datë 7.4.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 11.4.2023.
- Aktivitet *“Takim me banorë”*, raportuar në datë 10.4.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 14.4.2023.
- Aktivitet *“Takim me banorë”*, raportuar në datë 10.4.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 14.4.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në raportim nëpërmjet email – it dhe nga rrethanat dhe faktet, rezultoi se Bashkia Shijak ka hasur problematika në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për këtë shkak ka raportuar aktivitetet nëpërmjet email –it, në tejkallim të afatit me një ditë vonesë. Është provuar se Bashkia Shijak ka komunikuar nëpërmjet email – it me administratën e KQZ –së për të zgjidhur

këtë problematikë. Sipas nenit 4 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në rast se institucioni e ka të pamundur teknikisht aksesimin e ndërfaqes, mund të dërgojë raportimin nëpërmjet email-it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar brenda afatit ligjor. Megjithatë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton situatën e krijuar në këtë rast, sepse vonesa ka ardhur si pasojë e vështirësisë të aksesimit me sistemin dhe për këtë arsye vlerëson se nuk gjendemi para kundërvajtjes administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
2. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:
 - a) Prefekti i Qarkut Fier,
 - b) Bashkia Elbasan,
 - c) Bashkia Sarandë,
 - ç) Bashkia Devoll,
 - d) Bashkia Shijak,
3. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI